

Don Nikolai Gerasim
Rylov

III / 318

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.
(II. ad Cor. III. 17).

VOTER
KULTURE
SHOYPTARE

5-6

Máj-Gershuer 1940 - XVIII.

VJETI XVI.

S H K O D E R

Abonimi per „HYLLI I DRITËS“

Shqypni	Nji numer Fr. 0.80	Nji vjetë Fr. 7.—
Itali	» » » 0.80	» » » 7.—
Nder vende tjera . . .	» » » 1.20	» » » 10.—

Administratori: A. B. Dema

PERMBAJTJA

Y. — Nji nevojë një detyrë	fq. 201
LIN ÇIURÇIJA — Auto-edukata.	» 212
J. SCHMETZ — A kje ilirishtja një gjuhë KENTUM a por një gjuhë SATEM ?	» 116
P. D. KURTI — Kangë trimnive	» 220
BARDHYLI — Lushnja dhe Fshatrat per rreth saj	» 228
GELASIVS — Fjalori toponomastik	» 240
D. GASPER GURAKUQI — Zozji — Gramshi	» 245
D. ALEKSANDER SIRDANI — Gjamë	» 250
SPIRO KONDA — Apologjija e Sokratit	» 252
DENT. IBRAHIM DIBRA — Sherbimi e pastrimi i dhambve gëjatë shekujve	» 258
P. ANTON HARAPI — Valë mbi valë	» 265
DON PAL GJINI — Berlioni	» 273
D. GASPER GURAKUQI — Çuni	» 277
Dr. P. GJON SHLLAKU — Per historin kombtare	» 280
RIVISTA E SHTYPIT — V.A. — Revista d'Albania:	
« DO-KU — „Jeta kristjane“	
« GJIN SHPATA — Shkëndija	» 193
P. D. KURTI — Prralla. — Fas. 23	

HYLLI I DRITËS

E PERKOHSHME KULTURARE - LETRARE

Nji nevojë, nji detyrë.

«Perveç se çashtje, qi i përket ndërgjegjes së njeriut, feja ásht nji e mirë, ásht nji ndihmë e madhe edhe për jetën e kësajë bote. Parimet e fés, të ndjekuna mirë, i bájné njerzit qytetarë të ndershëm, i mësojnë qi t'i shërbejnë Atdheut, qi t'u shtrohen ligjvet të Shtetit.»

Luigj Gurakuqi

(Ora e Maleve 10-XI-1923. „Bazat e bashkëpunimit“)

NJIZET vjetët jete arsimore të regjimit të kaluem u pergjegjen gati pikë per pikë paralajmimeve qi epte nji prej bashkpuntorëvet t' onë nder mâ të squetët, At Ambroz Marlaskaj, qýsh ne vjetin 1922 me anen e nij brochure titullue: «Nji monument historik pazotsije në lamë të Ministrís s' Arsimit». Gabuen, jo pse nuk diejten, por pse nuk deshten të shifshin, nuk deshten të njifshin bazat e njimendta, mbi të cillat lypej të pështotej mirërritja e arsimi kombtar. Paten nisë per së mbrapshti, do të marojshin me doemos edhë mâ mbrapshtë; arsimi u bâ errsim. Errsim intrigash prozelitizmi majorance fetare në rrájë, të kallajtisuna herë per herë me frazeologji: «bashkim», «afetarizem», «asnjansí», «laicizem», «parime demokratike» e tjera këso dokrrash hîni, qi në vetveti nuk synojshin e nuk kishin per qellim tjetër vetem me pengue njato pak nisjativa të shndoshta private, të cillat mirërritjen e arsimin e pështetshin e e pështesin gjithnji sod mbi Zot e mbi moral të mvarun prej Tij.

Kështa ndolli qi shka mollen korren. Shkepun morali prej Zotit, institutet e masës së ré filluen të degjenerojshin

